



Promovimi i Punësimit nëpërmjet Zhvillimit të Biznesit dhe Shkathtësive
Zyra Bashkëpunuese MASHT/Danida

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kosovë

Rr. Agim Ramadani (përballë Fakultetit Ekonomik, kati 3-Të
10000 Prishtinë Kosovë.

Tel/Fax: +381 38 213 343

Mobile: 049 100 258/049 100 258

Email: mestdan@mestdan.com

www.mestdan.com

**VLERËSIMI I MATERIALEVE DHE UDHËZIMEVE MËSIMORE
EKZISTUESE PËR KATËR PROFILE BUJQËSORE**

MASHT/DANIDA – Tenderi 94709/09-904-321

Gusht 2009

Përgatitur nga:



Qendra për Zhvillim Rural

Dardania, L9 B/4-28, Prishtinë, Kosovë

E-mail: rdc_consulting@hotmail.com

Tel: +377 44 148 159; 044 196 235

PËRMBAJTJA

FALËNDERIM

Qendra për Zhvillim Rural i është mirënjohës Zyrës Bashkëpunuese MASHT/DANIDA), e cila mbështeti financiarisht këtë studim që ka për qëllim të vlerësojë materialet mësimore ekzistuese për të mësuarit teorik dhe praktik të nxënësve të katër shkollave dhe të jep rekomandime adekuate që kanë për qëllim fuqizimin e shkollave profesionale bujqësore.

Falënderojmë personelin arsimor të shkollave të mesme profesionale – bujqësore pa të cilët do të ishte i pamundur realizimit i këtij studimi.

Dëshirojmë të falënderojmë gjithashtu stafin e DANIDA-s, për konsultat e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë tërë kohës së realizimit të këtij hulumtimi.

Dhe në fund falënderojmë bashkëpunëtorët e jashtëm për kontributin e çmueshëm në realizimin e këtij studimi.

LISTA E AKRONIMEVE

AAP	Arsimi dhe aftësimi profesional
AKB	Aleanca Kosovare Bizneseve
ISCO	Standardet për klasifikim ndërkombëtar të profesioneve
KAAP	Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
QZHR	Qendra për Zhvillim Rural

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohen materialet mësimore ekzistuese për të mësuarit teorik dhe praktik të nxënësve në katër shkolla të mesme bujqësore dhe të jepen rekomandimet adekuate që kanë për qëllim fuqizimin e shkollave profesionale bujqësore për të edukuar dhe pajisur brezat e rinj me kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme që kërkohen sot nga tregu i punës.

Arsimi i mesëm profesional është padyshim njëra ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sot reforma arsimore në Kosovë. Të katër shkollat e mesme profesionale të përfshira në këtë studim janë në gjendje jo të kënaqshme, pasi karakterizohen me mungesë të laboratorëve dhe punëtorëve për mësim praktik, planprograme jo aktuale për nevojat e tregut, mungesë të materialit mësimor për mësues dhe nxënës, por edhe ai material i pakët që ekziston, nuk është cilësorë dhe nuk përmbush nevojat e nxënësve përkrah zhvillimit të industrisë bujqësore përkatëse.

Edhe pse shkollat e mesme profesionale bujqësore si qëllim parësor e kanë përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por edhe mundësinë e aplikimit në studime më të larta post sekondare dhe universitare, në praktikë sot këto dy qëllime realizohen mjaft dobët dhe me vështirësi të shumta. Kjo gjendje mund të konstatohet duke vlerësuar shkallën e ulët të nxënësve të punësuar pas përfundimit të shkollës, si dhe kalueshmërinë tejet të ulët të nxënësve në testin e maturës dhe numrin e vogël të nxënësve që ndjekin studimet, etj.

Planprogramet dhe metodat e reja të punës që zbatohen nëpër shkolla nuk garantojnë një aftësim adekuat profesional pasi kërkesat e jetës dhe tregut të punës kanë ndryshuar dukshëm.

Mungesa e teksteve bashkëkohore shkollore ka rezultuar me diktimin e mësimëve nga ana e mësimit të mësimdhënësve ku ende jepen informata të vjetruara, të panevojshme për zhvillimet e modernizuar dhe shprehin monotoni për nxënësit. Për përgatitjen e njëjësive mësimore, mësimit të mësimdhënësve përdorin tekstet e Fakultetit të Bujqësisë, që janë të vjetruara dhe nuk përshkruajnë me kapacitetin dhe aftësitë e nxënësve të shkollave të mesme që ti absorbojnë ato.

Meqenëse mungesa e teksteve është një problem akut, e ne anën tjetër përgatitja e tyre kërkon kohe, është e nevojshme që materialet mësimore të zhvillohen sipas prioriteteve bazuar në lëndet kyçe profesionale sipas profileve përkatëse. Për lëndet tjera të këtyre profileve sugjerojmë të përgatiten dispensa dhe materiale të tjera mbështetëse. Këto materiale mësimore duhet të shihen si zgjidhje e përkohshme deri në përgatitjen e teksteve mësimore sikur se për lëndet prioritare.

Nuk ekziston një lidhje e qëndrueshme dhe institucionale ndërmjet shkollave profesionale bujqësore dhe ekonomisë lokale, e që e vë në pikëpyetje edhe tërë kuptimin e ekzistimit të shkollave profesionale. Në nivel shkollor nuk ekziston ndonjë pikë kontakti (person, zyrë, grup përgjegjës) për ndërlidhje të shkollës me komunitetin privat të biznesit apo me ndërmarrjet publike, e që do të ndihmonte në ngritjen e nivelit të aftësisë të nxënësve për ndërmarrësi dhe do të mundësonte punësimin e nxënësve pas përfundimit të shkollimit.

Suksesi i ulët i treguar nga nxënësit është i ndikuar prej shumë faktorëve që përfshijnë cilësinë e mësimdhënies, ambientin mësimor, disponueshmërinë dhe cilësinë e materialeve mësimore si dhe motivimin dhe interesimin e nxënësve për arsimim dhe aftësim profesional.

Pasi preferencat e të rinjve për regjistrim në shkollat e mesme profesionale varen shumë nga emërtimet e drejtimeve si dhe nga perceptimi për mundësinë e punësimit pas përfundimit të shkollimit, duhet të merret në konsiderim riemërtimi i drejtimeve që ato të janë më atraktive për nxënësit dhe prindërit. Gjithashtu duhet të rekomandohen drejtime të reja atraktive dhe në përputhje me tregun aktual të punës.

2. HYRJE

Sistemi aktual i arsimit dhe formimit profesional bujqësor në Kosovë nuk është i nivelit të kënaqshëm pasi ka mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, nivel të ulët të burimeve njerëzore, financim të pamjaftueshëm të kuadrit mësimor, programe mësimore që nuk përputhen me nevojat e tregut të punës dhe fleksibilitet të pamjaftueshëm të procesit mësimorë. Të gjitha këto mangësi e limitojnë përdorimin racional të burimeve financiare e njerëzore në shkollat e mesme bujqësore në ofrimin e mësimit cilësor, në ngritjen profesionale dhe përgatitjen për tregun e punës të nxënësve.

Pasi në Kosovë rreth 60 % e popullsisë jeton në zonat rurale, përkrahja e zhvillimit rural do të ofronte punësim dhe mjete të qëndrueshme jetese për popullsinë rurale. Përgatitja profesionale dhe punësimi në fushën e bujqësisë dhe agrobiznesit ka një rëndësi të veçantë pasi këto fusha vlerësohen si potencial kryesor të punësimit ku edhe investimet në punësim do të ishin më të vogla krahasuar me sektorët tjerë të ekonomisë.

Edhe pse ekziston potenciali për zhvillim në sektorin bujqësor, shkollat profesionale bujqësore janë shumë pak tërheqëse për nxënësit, sidomos për ata që vijnë nga fshatrat. Një fenomen i tillë duket të jetë i ndikuar nga një numër i madh faktorësh, si: Mungesë e organizimit dhe përfshirjes së nxënësve në punë praktike, mungesë e fuqizimit të marrëdhënieve me publikun/komunitetin, Nevojë imediate për organizimin e trajnimeve teknike për arsimtar, emërtimet e drejtimeve jo-atraktive, mungesë për themelimin dhe funksionimin e drejtimeve të reja të cilat do të jenë plotësim i atyre ekzistuese dhe në trend aktual për zhvillimet e reja të tregut, mungesë e vlerësimit të tregut potencial të punës për nxënësit që kryejnë shkollat profesionale, bashkëpunim i ulët në mes shkollave simotra në vend dhe jashtë vendit, mungesë e materialeve mësimore adekuate për nxënës, etj.

Për t'u inkuadruar në familjen e madhe arsimore evropiane dhe që nesër të bëhemi konkurrent në tregun e përbashkët, para së gjithash duhet të zhvillohet ndenja e vërtetë për punë, të sigurohet kompetenca për nxënësit, si dhe për kuadrin mësimor, të kërkojnë që të arrihen standardet si për nxënësit, ashtu edhe për arsimtarët. Kjo e rritë nevojën që institucionet arsimore të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm nëpër shkolla profesionale, për të gjitha lëndët e programeve mësimore dhe për lëndët me zgjedhje, për të vënë në punë dhe përpara përgjegjësisë të metat që konstatohen në shkollat profesionale.

Kohëzgjatja e arsimit profesional është 2+1+1 pas shkollimit të detyruar 9 vjeçar, i ndarë në 3 nivele të definuar sipas standardit ndërkombëtar për kualifikim ISCED në përputhje me ligjet në fuqi. Niveli i parë përfshinë klasën 10+11. Kjo shkallë ofron kualifikimin bazik dhe mundëson punësimin në treg të punës si punëtor gjysmë i

kualifikuar. Niveli i II, është vazhdimësi e nivelit të I, përfshinë klasën 12, dhe ofron punësim në treg të punës si punëtor i kualifikuar. Nxënësit e shkollave profesionale kanë të drejtën e studimeve universitare edhe pas klasës së 12. Në klasën e 13, që është kryesisht përsëritje dhe thellim në modulet mësimore të tre viteve paraprake, nxënësit e shkollave profesionale bujqësore duhet të fitojnë aftësi dhe shkathtësi që të kyçen në tregun e punës në vend dhe jashtë.

Me gjithë përpjekjet për fuqizimin e arsimit profesional, funksionimi i shkollave profesionale bujqësore me një interesim të vogël të nxënësve, që i shërbejnë pak tregut të punës, tregon për gjendjen jo të kënaqshme që ato kanë. Janë një numër i problemeve serioze që ndikojnë në cilësinë e arsimit në shkollat profesionale si: gjendja jo e mirë e ndërtesave shkollore, mungesa e mjeteve dhe materialeve mësimore, interesimi i pakët për shkollën nga nxënësit, prindërit edhe komuniteti, mosinspirimi për mësimdhënie dhe mësimnxënie, mangësitë në zbatimin e programeve mësimore, menaxhimi në nivel jo të kënaqshëm i shkollave profesionale, etj. tregon për nivelin e ulët të shkollës profesionale bujqësore në Kosovë dhe për nevojën për një qasje serioze dhe profesionale për përmirësimin e gjendjes në shkollë.

Programi “Përmirësimi i Punësimit për të Rinjtë” që asiston Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në ngritjen e punësimit të të diplomuarve të shkollave të mesme profesionale të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore duhet të synojë që të krijoj qasje partneriteti me aktorët kryesorë për të institucionalizuar bashkëpunimin midis shkollave të mesme bujqësore dhe biznesit vendor, dhe fuqizimin e arsimit profesional në përputhje me tendencat evropiane të zhvillimit ekonomik e të tregut të punës.

Arritja e këtyre objektivave si dhe realizimi i ndërhyrjeve të tjera reformuese në përputhje me situatat që do të krijohen, do të kontribuojnë në ngritjen e dukshme cilësore dhe sasiore të arsimit profesional në kuadrin e përmbushjes së misionit të këtij sektori të rëndësishëm të zhvillimit të burimeve njerëzore.

3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Programi “Përmirësimi i Punësimit për të Rinjtë” që mbështetet nga qeveria Daneze ka për objektiv të asistojë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në fuqizimin e arsimit profesional të shkollave të mesme të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore, ngritjen profesionale të nxënësve dhe rritjen e mundësisë së punësimit për të diplomuarit nga shkollat e mesme bujqësore.

Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit është të vlerësohen materialet mësimore ekzistuese për të mësuarit teorik dhe praktik të nxënësve të katër shkollave të mesme bujqësore në profilet bujqësore: Lavërtari-Perimtari; Pemëtari-Vreshtari; Hortikulturë dhe Teknologji Ushqimore.

Për realizimin e projektit, janë vlerësuar dhe janë dhëne rekomandime për çështjet si ne vijim:

- a) Identifikimi i nivelit të zbërthimit dhe zbatimit të programeve mësimore nga mësimdhënësit
- b) Identifikimi i gjendjes ekzistuese dhe nevojave të shkollave profesionale bujqësore me mjete për realizimin e programeve mësimore (tekste mësimore, laboratorë, pune praktike, etj).
- c) Metodat e realizimit të mësimit teorik dhe praktik në shkolla.
- d) Bashkëpunimi mes shkollës dhe komunitetit, punësimi dhe vazhdimi i arsimimit universitar.
- e) Përhapja gjeografike e shkollave profesionale bujqësore
- f) Hulumtimi i mundësisë së riemërtimit të disa profileve të SHPB-ve, si dhe zhvillimi i profileve të reja atraktive.

Sipas rezultateve të hulumtimit do të jepen edhe rekomandimet adekuate që kanë për qëllim fuqizimin e shkollave profesionale bujqësore, dhe formimin e një kornizë bazë për zhvillimin e materialeve mësimore në të ardhmen bazuar në rekomandimet e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP).

4. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për realizimin e këtij hulumtimi janë grumbulluar materialet mësimore dhe udhëzuesit ekzistues për profilet ekzistuese të shkollave profesionale bujqësore në Kosovë si dhe materialet mësimore të vendeve të rajonit.

Për grumbullimin e të dhënave për gjendjen aktuale të shkollave është përgatitur pyetësori që përmban gjithsej 16 pyetje, ku për secilën pyetje është kërkuar të jepen përgjigje nga personeli arsimor në SHPB në Kosovë. Pyetësori i modifikuar është përdorur edhe gjatë intervistave me specialistë të fushave të arsimit dhe të personelit arsimorë në vendet e vizituara të rajonit. Pyetjet janë në përgjithësi rreth drejtimeve në shkolla, interesimit të nxënësve për drejtimet përkatëse, mënyrës së organizimit të mësimit teorik dhe atij praktik, aftësimit të nxënësve për ndërmarrësi, përqindjes së regjistrimit në fakultete dhe të punësimit pas përfundimit të shkollës.

Me qëllim të identifikimit të problemeve ekzistuese që kanë ndikim në mësimdhënie dhe mësimnxënie nëpër SHPB, bashkëpunimit të SHPB-ve me palët tjera të interesit (bizneset, industritë, institucionet, etj), si dhe krahasimi i tyre me shkollat simotra në vend dhe rajon, janë ndërmarrë disa vizita pune të paraqitura me poshtë:

Vizitat e realizuara në Kosovë

Vizita në këto shkolla profesionale bujqësore:

1. SHPB "Zenel Hajdini" në Ferizaj
2. SHPB "Arbëria" në Gjilan
3. SHPB "Ali Hadri" në Peja
4. SHPB "Latif Berisha" në Vushtrri

Janë realizuar vizita në Shkollat Profesionale Bujqësore në Lipjan dhe Prishtinë; Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB); Fermat komerciale dhe njësitë përpunuese (Prizren, Prishtine, Lipjan).

Krahasimi i shkollave profesionale bujqësore mes vete dhe me ato të rajonit

Për krahasim, janë ndërmarrë edhe disa vizita brenda dhe jashtë Kosovës. Është bërë krahasimi i SHPB-ve për organizimin e mësimit teorik dhe praktik kryesisht lidhur me pjesën praktike të organizimit të mësimit dhe marrëdhënieve mes shkollës dhe palëve tjera të interesit (bizneseve, fermave, institucioneve), nivelit të zhvillimit të industrisë në

vend dhe rajon si mase për punësim me te madhe të diplomuarve, kapacitetet e shkollave për përgatitjen dhe implementimin e projekteve, etj.

Vizitat e realizuara jashtë vendit

Në Shqipëri është vizituar Ministria e Arsimit, kontakt person Albina Buci; Mali i Zi (Ministria e Arsimit, kontakt person Dusan Boskovic – Udhëheqës i departamentit për arsim profesional dhe Natasa Mirecki, koordinatorë në përgatitjen e plan programeve; Maqedoni (shkolla e mesme bujqësore “Moshë Piada” në Tetovë, kontakt person Ali Aliu, udhëheqës i kësaj shkolle në gjuhën shqipe, Dr. Hazir Pollozhani, profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Mr. Namik Durmishi - Pedagog në Universitetin e Tetovës; Izet Zeqiri, Universiteti i Shtut'it).

Gjatë vizitave të realizuara në Shqipëri, Maqedoni dhe Malin e Zi, nga specialistët për përgatitjen dhe zbatimin e programeve mësimorë, janë marrë përvojat e këtyre vendeve për procesin e zhvillimit dhe zbatimin të programeve mësimore. Pastaj programet mësimore të shkollave profesionale nga Kosova janë krahasuar me ato të vendeve të rajonit që të vlerësohet pastaj cilësia e programeve mësimore, shkalla e zbatimit të tyre në praktikë dhe efekti i tyre në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Me vendet e rajonit janë krahasuar gjithashtu emërtimet e profileve ekzistuese, organizimi i trajnimeve teknike dhe pedagogjike në vazhdimësi që arsimtaret të përcjellin te reja të cilat ndodhin sot në bote, përpilimin e teksteve dhe materialeve tjera mësimore, pajisjen e laboratorëve dhe mjeteve tjera për punë praktike në shkollë, etj.

Organizimi i punëtorisë (workshopit) të I-rë, me rreth 30 pjesëmarrës me qëllim të identifikimit të problemeve me programet ekzistuese dhe nxjerrjen e rekomandimeve se cilat lloje të materialeve të reja të trajnimit duhet të zhvillohen.

Organizimi i punëtorisë së II-të, që grupi referent, ekspertet ndërkombëtar dhe vendor të japin komentet, rekomandimet, propozimet dhe sugjerimet për draft raportin “Vlerësimi i materialeve dhe udhëzimeve mësimore ekzistuese për katër profilet e bujqësisë”

5. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE DISKUTIMI

5.1 Roli dhe Rëndësia e Materialeve Mësimore për Arsimin dhe Aftësimin e Nxënësve

Transformimet, që sollën lindjen e ekonomisë së tregut, kanë shtruar nevojën për nivele të reja kualifikimi në drejtim të teknologjive e shërbimeve të reja. Orientimi nga tregu i punës si dhe nga praktika, së bashku me kërkesën për fleksibilitet, janë qëllimet kryesore për të edukuar dhe pajisur brezat e rinj me kualifikimet dhe shkathhtësitë e nevojshme, që kërkohen sot nga tregu i punës. Prandaj, programi i mësimin nga fushat e bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore duhet të ofrojë të gjitha njohuritë dhe aftësitë që janë të domosdoshme për menaxhimin e agrobiznesit në Kosovë, që të diplomuarit në shkollat e mesme bujqësore të kualifikohen për një punë kreative dhe inovative dhe përdorimin e suksesshëm të njohurive të fituara në prodhimtarinë bujqësore dhe teknologjinë ushqimore. Të diplomuarit e këtij profili duhet të kenë mundësi dhe aftësi të punësohen në ndërmarrje apo të punojnë të pavarur në fushat e organizimit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut të prodhimeve bujqësore.

Materialet mësimore kanë një ndikim kryesorë për të siguruar një arsim cilësorë për çdo anëtarë të shoqërisë, pa marrë parasysh pozitën shoqërore, gjininë dhe përgatitjen paraprake shkollore. Zhvillimi i programeve mësimore adekuate paraqet një proces kompleks që kërkon një adaptueshmëri maksimale për nevojat e nxënësve. Për zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e efektit të programeve mësimore tek nxënësit, nevojiten të angazhohen specialistë të lëmive të ndryshme me qëllim të përgatitjes maksimale të nxënësve në aspektin profesional dhe të ndërmarrësisë. Zbatimi i materialeve mësimore të reja nuk nënkupton vetëm zëvendësimin e një pjese të përmbajtjes me një tjetër, por prezantimin e qasjeve të reja në mësimdhënie dhe mësim nxënie.

QZHR ka mbledhur dhe analizuar materialet mësimore ekzistuese në 4 profilet bujqësore të shkollave profesionale në Ferizaj, Gjilan, Pejë dhe Vushtrri. Cilësia e materialeve mësimore, zbatimi dhe përshtatshmëria e tyre me nevojat e tregut të punës janë diskutuar me përfaqësuesit e sektorit publik dhe atij privat, siç është paraqitur në vijim:

- Përfaqësuesit e shkollave profesionale bujqësore
- Grupin referent të programit DANIDA dhe partnerët tjerë në rishikimin dhe finalizimin e procesit të vlerësimit.
- Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit si Aleanca Kosovare e Bizneseve

Për arsye të mungesës së objekteve dhe pajisjeve për punë praktike, shkollat e vizituara mesatarisht modifikojnë rreth 20 - 30 % të materialeve mësimore. Nga vëzhgimet e bëra është vërejtur që ka edhe ngurrime për të adaptuar dhe zbatuar planprogramin e ri.

Gjatë vlerësimit të materialeve mësimore është vërejtur një dukuri e emërimit të moduleve mësimore sikurse në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë, e që nuk i përgjigjet as për së afërmi nivelit të nxënësve të cilëve ju dedikohen këto materiale mësimore.

Është me interes të rishikohet edhe ndarja e shkollimit në tre nivele. Në bazë të të dhënave të mbledhura dhe të analizuara, nuk kemi hasur në asnjë rast që ndonjë nxënës të ketë konkurruar në shkollë me qëllim që ta kryej vetëm nivelin e parë apo të dytë, apo që ndonjë nxënës ta ketë përfunduar shkollimin në nivelin e parë apo të dytë. Nëse ka ndodhë ndonjë rast i tillë, ai ka qenë për arsye tjera por jo pse nxënësi ka dashur që ta përfundoj mësimin në këtë nivel. Gjithashtu kriteret e vendosura në fillim për t'u regjistruar nga niveli i dytë në klasën e 13 (që në fillim ka qenë nota mesatare së paku 3 për tri vite) kanë ardhur duke u "zbutur" vazhdimisht. Konstatimi i ynë është që të gjithë nxënësit të cilët regjistrohen në këto shkolla vijnë me qëllim që ta kryejnë edhe klasën e 13. Duke marrë parasysh këto të dhëna duhet të rishikohet kjo ndarje, nga që edhe shpërndarja e lëndëve nëpër vite është bërë duke u bazuar në këtë ndarje dhe nxënësit janë ngarkuar me shumë lëndë në nivelin e parë, e në një masë edhe në nivelin e dytë.

Ndarja në tri nivele të shkollimit për profilet bujqësore nuk është harmonizuar nga hartuesit e materialeve mësimore pasi që renditja e lëndëve mësimore në mjaft raste është konfuze. P.sh. Lënda Perimtari dëgjohet para lëndës Lavërtari e Përgjithshme me Agroekologji. Për aq sa ka mundësi, lëndët e përgjithshme si Mekanizimi bujqësor, Toka dhe të ushqyerit e bimëve, etj duhet të kenë të njëjtën përmbajtje programore për të gjitha drejtimet, që do të lehtësonte zbatimin e këtyre programeve.

Me përjashtim të drejtimit Teknologji Ushqimore, asnjë drejtim tjetër nuk është e cituar literatura e cila ka shërbyer si bazë për përgatitjen e planprogrameve.

Në planprogramet e reja është paraparë një pjesë fakultative për të gjitha drejtimet, që përfshinë 10 deri 20% të planit mësimor, varësisht nga drejtimi dhe lënda. Megjithëse, kjo pjesë fakultative i ofron shkollës një mundësi për të përshtatur modulet mësimore nevojave të veçanta të edukimit të nxënësve, kjo pakë përdoret në praktikë pasi nuk ka një vullnet dhe vetëmohim për zbatimin e sajë nga mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollës.

Në shkollat profesionale bujqësore nuk ka lëndë të mirëfillta zgjedhore, por nxënësit janë vënë në mes të alternativave për këtë apo atë lëndë. Me reformë janë shtuar lëndët mësimore, por nxënësve nuk ju është mundësuar që të zgjedhin lëndët zgjedhore me qëllim që të angazhohen në atë lëmi që do ta mësojnë e ta studiojnë.

5.2 Vlerësimi i Moduleve Mësimore Sipas Profileve të Shkollave

1. Drejtimi: LAVËRTARI – PERIMTARI

- Të gjitha modulet janë të emërtuara tekstualisht sikurse në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë;
- Me qëllim që të përfshihen të gjitha lëndët që ekzistojnë në Fakultet ka ndikuar që të rritet pa nevojë numri i lëndëve;
- Në tabelën e programit mësimor për drejtimin Lavërtari – Pemëtari, faqe 11, dy lëndë janë dhënë me nr. rendor 13: 1. Lavërtari e përgjithshme me agroekologji dhe 2. Teknologjia e përpunimit të prodhimeve lavërtare-perimore;
- Lëndët Perimtaria në mjedise të mbrojtura dhe Gjenetikë me seleksionim, të cilat dëgjohej në klasën e 12-të, duhet të hiqen në tërësi, pasi që këto duhet të jenë pjese e lëndëve tjera (Perimtaria, Lavërtaria e përgjithshme me agroekologji, dhe Lavërtaria speciale);
- Nuk ka asnjë arsye që nxënësit që punojnë në fermë të ngarkohen me gjenetikë dhe seleksionim. Kjo lëndë nuk ekziston në asnjë shkollë profesionale bujqësore në vendet e rajonit. Materiet mbi këto lende duhet të shtjellohen se kaptina të veçanta në lendet tjera;
- Në vend të këtyre lëndëve që dëgjohej me nga një orë në javë (Gjenetikë me seleksionim, Perimtaria në mjediset e mbrojtura) do të ishte me reale që të ketë një lëndë nga Menaxhimi i prodhimtarisë në lavërtari – perimtari (në nivel të fermës). Me këtë rast nuk do të zvogëlohej numri i orëve pasi që kjo lëndë do të dëgjohej me 2 orë në javë.
- Lënda Organizimi i prodhimtarisë lavërtare – perimore, nuk ekziston në drejtimin e Lavërtarisë por ekziston në drejtimin e Pemëtarisë. Është mirë që një lëndë që trajton problemin e organizimit dhe menaxhimit në fermë të futet si e këtillë, por në vend të emërtimit Organizim, që është marrë nga modulet mësimore të vjetra të Fakultetit të Bujqësisë, të përdoret emërtimi Menaxhim.

Vetëm tek ky drejtim është dhënë moduli i praktikës profesionale “Praktikum i kimisë”, që nuk ndodhet tek asnjë program tjetër që ne e kemi analizuar.

Lëndët në vazhdim duhet të riorganizohen sipas kësaj skeme:

1. Në vend të dy lëndëve për Teknikën bujqësore, mund të jetë vetëm një lëndë (shembulli i vendeve tjera në rajon, p.sh. Mali i Zi).
2. Lënda Prodhimi i farës, nuk ka nevojë të jetë si lëndë e veçantë.
3. Lavërtaria e përgjithshme mund të jetë bashkë me bimët foragjere ose të jete se bashku me Lavërtarinë speciale, që do të mund të quhej “Prodhimi i bimëve të arave”

- Në përmbajtje shkruan se lënda e Perimtarisë dëgjohe në klasën 11 dhe 12 (f. 3), Në klasën e 11 me fond tri orë në javë ndërsa në klasën e 12, një orë në javë. Rekomandojmë që kjo të jetë vetëm një lëndë e të dëgjohe në klasën e 12. (Edhe ne Fakultet dëgjohe vetëm një lëndë me emrin “Prodhimi i perimeve”).
- Lënda Kimi, në përmbajtje (f. 3) është dhënë si Kimi, në pasqyrën e lëndëve në tabelë (f. 11) është shënuar si Kimi e përgjithshme dhe inorganike. Me këtë emër është edhe në përmbajtjen programore (nga f. 21). Gjithashtu ajo nuk përfshinë fare kiminë organike. Propozojmë që gjithsesi të përfshihen edhe materialet më të nevojshme nga kimia organike dhe lënda të quhet “Kimi”, ashtu siç është dhënë në përmbajtje dhe siç është në drejtimin e Hortikulturës.
- Në lëndën e Mekanizimit disa kapituj si Makinat për punimin themelor të tokës në drejtimin e lavëtarisë janë paraparë të jenë 6 orë, kurse për të njëjtin kapitull në drejtimin e pemëtarisë janë paraparë 11 orë. Është mire që këto të unifikohen sa më shumë që ka mundësi. Makinat për korren-shirjen e drithërave 6 orë ë krahasuar me rëndësinë dhe në raport me kapitujt tjerë është shpërndarje shumë jo korrekte. Këto pjesë duhet të rishikohen pasi që nuk ka asnjë rezon që të jetë një shpërndarje e këtillë.
- Pajisjet për realizimin e lëndëve duhet të rishikohen dhe mundësisht të përshtaten me mundësitë reale të shkollave. P.sh. pse është paraparë TV tek realizimi i çdo teme ?
- Duhet përmirësuar gabimet gjuhësore (teknike), që në disa raste e humbin kuptimin e fjalëve si. p.sh. (Përshkruesi i Modullit të **Prasktuikës** Profesionale), f. 43.

Në Lëndën e Biologjisë ka disa kapituj që mendojmë se janë të tepërta për nxënësit: P.sh. nuk është e nevojshme që nxënësi të “Përshkruaj metodat e kërkimit shkencor në citologji” (f. 16).

Gjithashtu ka përsëritje të shumta të temave të njëjta në lëndë të ndryshme si p.sh:

- Biologji, Kapitulli 1: Citologjia - ndërtimi qelizor dhe përmbajtja kimike e qelizës, nga lënda e biologjisë, (f. 64)
- Botanikë Kapitulli 3: Biologjia e qelizës (f. 17)
- Gjenetikë me seleksionim (Kapitulli 3: Qeliza, kromozomet dhe ndarja qelizore - 5 orë).
- Të njëjtat tema në Biologji, Kapitulli 3: Biologjia e qelizës 6 orë, dhe Kapitulli 6: Gjenetika-baza materiale e trashëgimisë, 14 orë (f. 17), dhe
- Kapitulli 1: Citologjia - ndërtimi qelizor dhe përmbajtja kimike e qelizës - 15 orë, në Botanikë f. 61

Mbrojtja e Bimëve

Një mungesë e madhe është pasi nuk kemi asnjë fjale për mbrojtën e kulturave lavërtarë perimore por i tërë programi është bartur gabimisht te mbrojtja e bimëve dekorative ! Nuk përmenden fare asnjë sëmundje qoftë e bimëve lavërtarë, apo perimore!. Duhet zhvilluar të tërë planprogramin për këtë lëndë, pasi që ai nuk ekziston fare, në programet mësimore, përveç që është dhënë në përmbajtje.

Kushtet për realizimin e kapitullit janë paraqitur si vijon: Materiale didaktike, skica, foto, sllajda dhe prospekte. F. 76. Këto duhet të riformulohen dhe mos të përshkruhen në këtë formë.

Përsëritjet e përmbajtjeve të njëjta tek lëndët e ndryshme është mjaft e shprehur. P.sh. Në lavërtarinë e përgjithshme plehërimi ka 10 orë, ndërsa për të njëjtën temë ka në Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve.

Lavërtari Speciale

Kapitulli 3: Bishtajoret 15 orë ndërsa Kapitulli 2: Drithërat 10 orë, Kulturat tekstilore 10 orë. Shpërndarja e këtyre orëve nuk është profesionale pasi që nuk mund të kenë drithërat 10 orë sikurse dhe kulturat tekstilore.

Perimtaria në mjedise të mbrojtura (ky titull i lëndës nuk ka kuptim). Sugjerojmë që kjo lëndë të fuzionohet së bashku me Perimtarinë dhe të jetë vetëm një lëndë. Përndryshe edhe nëse mbetet si lëndë e veçantë (çka nuk ka kuptim), duhet të rishikohet komplet pasi që nuk i përshtatet fare lëndës me këtë titull. P.sh:

- Kapitulli 1: Historiku i mjediseve të mbrojtura, ndërtimi i tyre 7 orë. Nuk ka arsye që nxënësve tu shpjegohet 7 orë për historinë e mjediseve të mbrojtura.
- Kapitulli 3: Aspekte fiziologjike në mjedise të mbrojtura ?, duhen riformuluar emrat e kapitujve pasi aspektet fiziologjike duhet analizuar te bimët e jo te objektet.
- Nuk bëhet dallimi në mes të mjediseve të mbrojtura dhe serrave si p.sh. (Kapitulli 5: Kultivimi i domates dhe specit në serra)
- Fondi i orëve gjithashtu është shpërndarë në mënyrë shumë jo të drejtë: Kapitulli 5: Kultivimi i domates dhe specit në serra ka 7 orë, Kapitulli 6: Kultivimi i perimeve gjethore në serra ka njëjtë 7 orë, që për nga rëndësia dhe ndikimi ekonomik duhet të ketë më pak orë.

Gjenetikë me Seleksionim:

- Kapitulli 3: Qeliza, kromozomet dhe ndarja qelizore - 5 orë.
- Të njëjtat tema në Biologji, Kapitulli 3: Biologjia e qelizës - 6 orë,
- Kapitulli 6: Gjenetika-baza materiale e trashëgimisë - 14 orë (f. 17) dhe
- Kapitulli 1: Citologjia - ndërtimi qelizor dhe përmbajtja kimike e qelizës - 15 orë, në Botanikë f. 62

Kjo lëndë duhet të hiqet si lëndë e veçantë. Disa kaptina mund të futen në kuadër të lëndëve tjera, ndërsa kaptinat tjera nuk ka arsye që të shpjegohen fare.

Moduli i praktikës profesionale “Kontrolli Fushor - Inspektimi”, është një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer kontrollin fushor të një sipërfaqeje të caktuar për prodhimin e farës duke vlerësuar pastërtinë e kultivarëve si dhe cilësinë e farës së prodhuar. Por, në kompetencat profesionale që nxënësi i arrin (f. 10) nuk shkruan askund që nxënësi pas shkollimit aftësohet për kontroll dhe inspektim të parcelave për farë. Atëherë, pse ta ngarkojmë nxënësin me këtë modul !.

2. Drejtimi: PEMËTARI – VRESHTARI

- Lënda Kimi, në përmbajtje (f. 3) është dhënë si Kimi, në pasqyrën e lëndëve në tabelë (f. 11) është shënuar si Kimi e përgjithshme dhe inorganike. Me këtë emër është edhe në përmbajtjen programore (f. 22). Gjithashtu ajo nuk përfshinë fare kiminë organike. Propozojmë që gjithsesi të përfshihen edhe materiale nga kimia organike dhe lënda të quhet “Kimi”, ashtu siç është dhënë në përmbajtje dhe siç është dhënë në drejtimin e Hortikulturës.
- Te lënda “**Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve**”, në drejtimin Pemëtari (f. 31), në vend të profilit Pemëtari – Vreshtari në hyrje shkruan profili Lavërtari – Perimtari
- Lënda: “**Fisnikërimi i pemëve dhe i hardhisë**”, duhet të thjeshtohet programi (p.sh. Metodatat e formimit të kultivarëve të rinj - 7 orë, Mënyrat e hibridizimit 11orë). Këto kaptina mund të jenë shumë më të shkurtra.

Lënda **Pemëtari e përgjithshme** (Kapitulli 7: Plehërimi i pemëve - 11orë me këto tema të kapitullit:

- Makroelementet
- Mikroelementet
- Plehrat organike dhe minerale
- Plehrat azotike
- Plehrat fosfatike
- Plehrat potasike

Të gjitha këto tema shpjegohen tek **Toka dhe të ushqyerit**.

- Ndërsa Kapitulli 4: Shumimi i pemëve - 4 orë, fondi i orëve për këto dy kaptina duhet të ndryshohet.
- **Lënda Mbrojtja e pemëve dhe hardhisë** është shtjelluar mirë dhe duhet të jetë shembull edhe për dy drejtimet tjera (Lavërtari –perimtari dhe Hortikulturë)
- Lënda **“Prodhimi i fidanëve të pemëve e hardhisë”**, nuk ka nevojë të jetë lëndë e veçantë por mund të jetë pjesë e Pemëtarisë së përgjithshme dhe Vreshtarisë me ampelografi. Një pjesë e Vreshtarisë veç flet për këtë temë (Kapitulli 3 që ka 10 orë: Shumimi i hardhisë f. 88 dhe 89).
- Për lëndën Biologji vlej në të njëjtat që janë dhënë tek drejtimi Lavërtari – Perimtari

Lënda “Organizimi i prodhimitarisë pemëtare-vreshtare”

Ekzistojnë disa tema që nuk janë të nevojshme, siç janë:

- Kapitulli 1: Organizimi dhe detyrat e tij !,
- Lidhja e organizimit me lëndët e tjera,
- Kapitulli 4: Ndërmarrjet bujqësore,
- Ndërmarrjet individuale bujqësore,
- Ndërmarrjet shoqërore bujqësore ! (f. 124)

Duhet të rimerthohet dhe të shkruhet komplet plan-programi për të.

3. Drejtimi: HORTIKULTURE

- Lënda e **Biologjisë** duhet të jetë e njëjtë për të gjitha drejtimet (Lavërtari, Pemëtari dhe Hortikulturë). Në hortikulturë dallon nga dy drejtimet e mëhershme.
- Në përmbajtje në f. 3, janë dhënë dy lëndë të mbrojtjes së bimëve (klasa e 10 dhe 11), Ndërsa në tabelën për planet mësimore në f. 10, është dhënë vetëm mbrojtja e bimëve në klasën e 12.
- **Mekanizimi në pemëtari-veshtari dhe hortikulturë** duhet të jetë e njëjta lëndë. Janë dallime shumë të vogla dhe si të tilla duhet të unifikohen dhe mund të jetë e njëjta lëndë për të dy drejtimet. P.sh. Kapitulli për lubrifikantët tek drejtimi Pemëtari ka 5 orë ndërsa tek drejtimi Hortikultura ka 4 orë. Kapitulli Makinat për punimin themelor dhe plotësues te tokës, në Pemëtari – Vreshtari ka 11 orë, i njëjti kapitull në hortikulturë është i ndarë në dy kapituj (f. 39 dhe 40) dhe ka 13 orë, etj.

- Lënda: **Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve**, në tabelë është dhënë me fond 3 orë në javë ndërsa gjatë shtjellimit të programit të lëndës është dhënë me dy orë në javë, dhe komplet planprogrami është përgatitë për këtë fond të orëve (70 orë përkatësisht dy orë në javë). Si i këtillë ky planprogram dallon nga ai në Lavërtari me Perimekulturë dhe ai Pemëtari - Vreshtari. Sugjerojmë që ky program të jetë i njëjtë për këto tre drejtimet.
- Lënda **Kimi**, këtu është komplet ndryshe nga dy drejtimet mëhershme. Këtu plani është komplet, dhe ky plan duhet të vlejë edhe për dy drejtimet tjera.
- Lënda **“Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve”**, duhet të ketë program të njëjtë sikurse drejtimi Lavërtari dhe Pemëtari. Pasi që për temat e njëjta ka fond të ndryshëm të orëve, p.sh. kaptina Përbërja e tokës këtu ka 7 orë, ndërsa tek dy drejtimet tjera ky kapitull emërtohet vetëm pak më ndryshe (Njohuri të përgjithshme për përbërjen e tokës) dhe ka 10 orë. Plehrat organike këtu kanë 9 orë ndërsa në drejtimet tjera 10 orë. Plehrat minerale në hortikulturë i kanë 9 orë, kurse në dy drejtimet tjera i kanë 17 orë.
- Lënda **Mbrojtja e Bimëve** nuk përmend fare problemin e barojave dhe të herbicideve.

4. Drejtimi: TEKNOLOGJI USHQIMORE

- Lënda Kimi analitike është më mirë që të jetë vetëm në klasën e 11 dhe 12 me nga dy orë në javë se sa në tri vite (klasën 10,11 dhe 12), me nga një orë në javë.
- Lënda biokimi në planin e ri parashihet të ketë vetëm një orë që është shumë pakë për këtë profil.
- Lënda Mikrobiologji dhe higjienë në klasën e dymbëdhjetë duhet të rritet fondi për një orë që të mundësojë realizmin më të mirë të planit mësimor.
- Lënda Biologji duhet të jetë e njëjtë sikurse në drejtimet tjera.
- Lënda **“Lënda e parë ushqimore”**, ndoshta duhet ndarë në dy pjesë pasi që është shumë e ngarkuar (p.sh. lënda e parë me origjinë bimor dhe ajo shtazore).
- I vetmi ky program nga ato të përfshira në projekt e ka të referuar në fund literaturën e përdorur për përgatitje të moduleve mësimore.

Disa rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e materialeve mësimore

Zbatimi i materialeve mësimore moderne dhe më afër praktikës mund të realizohet duke përshtatur plan-programin ekzistuese, në një kurrikulë kornizë më fleksibile me një pjesë më të madhe punës praktike si dhe më shumë orientim nga tregu bujqësor i punës.

Në kurrikulen kornizë duhet të përfshihen të gjitha lëndët e nevojshme për një formim profesional të punësuarve të ardhshëm të ndërmarrjeve bujqësore. Rëndësi të veçantë duhet vënë zgjerimit të profilit arsimor dhe rritjes së numrit të orëve në mësimin praktik dhe organizimit të tij. Mësuesit duhet të përshtatin përmbajtjen e materialeve mësimore në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesave në ndryshim dhe gjendjes ekzistuese në shkollë dhe në tregun e punës.

Programet mësimore të hartuara në nivel qendror duhet të harmonizohen me nivel shkollë, të bazuara në kërkesat reale të tregut rajonal të punës dhe mundësitë konkrete të shkollës.

Reforma aktuale në arsim që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë mund të shkojnë huq në qoftë se së pari nuk identifikohen dhe kuptohen qartë problemet si dhe shkakut dhe zgjidhja e tyre.

Pa përmirësimin e menaxhmentit, trajnimit për mësimdhënës, materialeve dhe kushteve të mësimin dhe pa pjesëmarrjen dhe përkrahjen e mësuesve dhe komunitetit në këtë proces, vështirë se do të ketë sukses.

Duhet një angazhim i vazhdueshëm në fuqizimin e mekanizmave institucionale aktualë vepër trajnimitin e vazhduar metodik dhe profesional, të të gjithë mësimdhënësve.

Hartimi i materialeve mësimore

Mungesa e teksteve mësimore ndikon shumë në pamundësinë e implementimit të kurrikulave për profilet përkatëse. Shumica prej mësimdhënësve nxjerrin pjesë të caktuara nga tekstet e ndryshme, të cilat jua diktojnë nxënësve dhe ata marrin shënime. Kjo bëhet pa një rregull të caktuar kështu që mund të ndodhë që, për të njëjtën problematikë, nxënësit nga shkolla të ndryshme të shfrytëzojnë materiale krejtësisht të ndryshme. Kjo mënyrë e dhënies së mësimin është shumë e tejkualuar dhe nuk garanton cilësi. Duke marrë parasysh këta faktor, është shumë e nevojshme që sa më shpejt të fillohet me përgatitjet për botimin e teksteve mësimore, që është çelësi kryesor për ngritjen e cilësisë së mësimin në shkollat bujqësore. Për këtë arsye është e nevojshme që paraprakisht të ndërtohet një strategji për qasje sa më profesionale për zgjidhjen e këtij problemi.

Është me shumë interes të analizohen mundësitë se për cilat tekste ne mund të bëjmë zgjidhje. Në bazë të kësaj analize, për tekstet që nuk do të mund të arrinim t'i përgatisim në mënyrë cilësore dhe në kohë, është mirë që të shqyrtohet mundësia e përkthimit të teksteve mësimore nga vendet tjera, krahas përshtatjes së tyre sipas specifikave vendore (shembulli i disa vendeve në regjion).

Në shkollat profesionale bujqësore mungojnë tekstet mësimore apo punohet me tekste jo funksionale dhe niveli i njohurive që ofrojnë këto tekste tek nxënësit është i ulët. Mungesa e teksteve mësimore është problemi kryesor për realizimin e mësimimit për t'ritur në shkollat profesionale të Kosovës.

Mungesa e teksteve adekuate mësimore ka obliguar mësimdhënësit që gjatë mësimimit të shërbehen me tekste të përafërta mësimore apo tekste alternative. Për sigurimin e materialeve mësimore, mësimdhënësit kanë shfrytëzuar tekstet/shënime nga Fakulteti i Bujqësisë, të cilat edhe ashtu janë paketa. Këto materiale as për së afërmi nuk i përgjigjen aftësive psiko-fizike dhe kapaciteteve absorbuese të nxënësve të shkollave të mesme, janë monotone dhe jo aktuale.

Rekomandime për hartimin e programeve dhe teksteve mësimore

- Ekziston nevoja për të zhvilluar politika dhe strategji ku materialet mësimore mund të prodhohen dhe shpërndahen në mënyrë të qëndrueshme, të përbalueshme dhe me kosto sa më efektive si dhe të jenë konsistente me burimet financiare të disponueshme në sektorin e arsimit.
- Tekstet mësimore duhet patur vijimësi nga klasa në klasë dhe nga cikli në cikël.
- Në to duhet të ketë përputhje midis temave dhe programeve mësimore, gjë që nevojitet koordinim të punës midis autorëve të teksteve dhe hartuesve të programit mësimor, ku autorët e teksteve duhet të njihen pa tjetër me programet mësimore.
- Duhet të hartohen tekstet alternative sipas programeve të miratuara dhe nevojave të nxënësve (udhëzues praktik, broshura, katalogë, programe softuerike për realizimin e projekteve praktike).

Shembull i zhvillimit të materialeve mësimore

Për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për të arritur objektivat e arsimit dhe aftësimit profesional, materiale mësimore duhet hartuar nga grupe specialistesh të lëmijve përkatëse (paketa mësimore sipas specialiteteve). Si shembull për përgatitjen e teksteve mësimore mund të konsiderohet përvoja e Malit të Zi, ku është aplikuar një metodë e kombinuar e sigurimit të teksteve cilësore, aktuale dhe

lehtë të adaptueshme për nxënësit. Për ato tekste mësimore që ka ekzistuar përvoja dhe ekspertiza në Mal të Zi, ato janë zhvilluar në vend, ndërsa tekstet tjera janë siguruar nga vendet tjera, si p.sh., nga Sllovenia duke e bartë/blerë të drejtën e autorëve, dhe përshtatur kushteve të vendit sipas formës dhe përmbajtjes moderne të teksteve.

Sugjerimet për zhvillimin e materialeve mësimore ne Kosove

Për veç parakushteve të përmendura më lartë është e rëndësishme që gjatë përgatitjes së planit për hartimin e teksteve të merret parasysh edhe numri i nxënësve nëpër profilet e shkollave profesionale, kohëzgjatja e përgatitjes së materialeve mësimore, kostoja e botimit të tyre.

Është e nevojshme që lëndet mbështetëse (si p.sh: Mekanizimi Bujqësor, Bazat e Tokës dhe Plehërimi, Mbrojtja e Bimëve) të mbulojnë nga një tekst i përbashkët për profilet përkatëse.

Meqenëse mungesa e teksteve është një problem akut, e në anën tjetër përgatitja e tyre kërkon kohë, është e nevojshme që materialet mësimore të zhvillohen sipas prioriteteve bazuar në lëndet kyçe profesionale sipas profileve përkatëse:

Profili: Lavërtari-Perimtari

1. Lavërtari Speciale,
2. Perimtaria,
3. Mbrojtja e Bimëve

Profili: Pemëtari – Vreshtari

1. Pemëtari Speciale
2. Vreshtaria me Ampelografi
3. Mbrojtja e Bimëve

Profili: Hortikulturë

1. Prodhimi i fidanëve
2. Kultivimi i luleve njëvjeçare dhe qepore
3. Kultivimi i luleve shumëvjeçare

Profili: Teknologji Ushqimore

1. Lënda e parë ushqimore

2. Teknologjia ushqimore
3. Makinat dhe proceset teknike

Zhvillimi i materialeve mësimore

Tekstet mësimore të propozuara sipas formatit dhe përmbajtjes moderne mund të zhvillohen nga:

- grupe autoresh vendor,
- autor jashtë vendit,
- bashkëpunim mes autoreve vendor dhe te jashtëm,
- përkthimi nga gjuhët tjera (përvojat e vendeve të rajonit),
- Zhvillimi i materialeve mësimore të përbashkëta me Shqipërinë për lëndet me përmbajtje të njëjtë apo të përafërt programore.

Për lëndet tjera të këtyre profileve sugjerojmë të përgatiten dispensa dhe materiale të tjera mbështetëse. Këto materiale mësimore duhet të shihen si zgjidhje e përkohshme deri në përgatitjen e teksteve mësimore sikur se për lëndet prioritare.

Metodat e realizimit të mësimimit dhe trajnimit i mësimdhënësve

Pasi mësimdhënia është kryesisht teorike, bile edhe për lëndët praktike, dhe mësimi teorik për të gjitha lëndët, mbulon prej 80 e deri në 100 % të kohës së caktuar, nevojitet një reformë imediate për zbatimin e një metodologjie arsimore moderne.

Në tërësi mungon ngritja profesionale (teknike) e mësimdhënësve. Përveç disa trajnimeve pedagogjike, në asnjë rast arsimtarët nuk kanë patur mundësi që të kenë ndonjë trajnim, vizitë studimore, apo diç të ngjashme që do të ju ndihmonte atyre t'i transferojnë njohuritë për teknikat bashkëkohore të prodhimtarisë bujqësore dhe agrobiznesit. Në vende të rajonit ngritja e vazhdueshme profesionale e arsimtarëve është praktikë e rregullt. Ky problem duhet trajtuar me mjaft kujdes, pasi që teknikat e kultivimit zhvillohen dhe perfeksionohen në vazhdimësi. P.sh. nëse marrim parasysh se disa nga mësimdhënësit kanë kryer studimet para më shumë se 20 vite, teknikat e aplikuara në atë kohë ndryshojnë shumë nga ato që përdoren sot. Si shembull janë teknikat që sot përdoren në prodhimin bashkëkohor të perimeve (prodhimi i fidanit në module, të ushqyerit me plehra kristalor, etj). Nëse kësaj i shtojmë edhe mungesën e literaturës profesionale në gjuhën shqipe, atëherë ky problem bëhet edhe më serioz. Për këtë arsye ngritja profesionale e arsimtarëve duhet të jetë një nga aktivitetet e

rëndësishme në këtë sektor. Kjo ngritje para së gjithash do të bazohet në trajnimet disa ditore gjatë vitit për probleme specifike, e sidomos për teknikat e reja të kultivimit.

Nga vëzhgimet e bëra në disa SHPB është parë që metodat mësimore janë të vjetra dhe jashtë trendit modern. Mësimi kryesisht zhvillohet me metodën didaktike, me orientim kah mësimdhënësi si dhe të mësuarit është teorik. Nxënësit rrallë paraqiten si pjesëmarrës aktiv gjatë zhvillimit të orës mësimore apo të mësojnë se si të zhvillohet të menduarit kreativ dhe në mënyrë të pavarur.

Mësimdhënësit shpeshherë i shpjegojnë gjërat e njëjta të cilat i kanë mësuar në fakultet, duke përdorur tekstet dhe shënimet e njëjta shkollore.

Rezultatet e hulumtimit të nxënësve të intervistuar në shkollat e mesme bujqësore sa i përket nivelit të përgatitjes arsimore të mësimdhënësve për lëndët mësimore të cilat i mbajnë tregojnë për një opinion jo të kënaqshëm të nxënësve për mësimdhënësit. Rreth 40% e nxënësve mendojnë se mësimdhënësit e tyre kanë kualifikime të larta dhe janë profesionist në lëndët mësimore, rreth 40% mendojnë se kualifikimet e mësimdhënësve të tyre janë mesatare, dhe rreth 15% e opinionit të nxënësve tregon se mësimdhënësit nuk janë profesionist¹.

Rekomandimet për përmirësimin e njohurive profesionale-praktike të mësimdhënësve për metodat e realizimit të mësimin

Trajnimi i mësimdhënësve

- ❖ Duhet të përdoren metodat praktike të mësimdhënies e si shembull mund të merret shkolla bujqësore në Lipjan ku puna praktike zënë gjysmën e orëve mësimore.
- ❖ Duke u nisur nga lëndët profesionale të planit mësimor, duhet përcaktuar fushat e trajnimit për mësimdhënësit. Për këto fusha duhet zhvilluar seanca praktike me disa seminare paralele. Duhet të ofrohet trajnime teknike për mësimdhënësit për përdorimit dhe aplikimit të teknologjive të reja krahas ndryshimeve tekniko-teknologjike, përdorim të kompjuterit, njohje të gjuhës angleze. Trajnimet teknike mund të organizoheshin se paku dy here në vit nga 5 dite trajnimi (gjate pushimit dimërore dhe verore).
- ❖ Një përvojë e rëndësishme janë edhe udhëtimet studimor në shtetet në rajon dhe BE-së (Kroaci, Slloveni, Austri, etj) ku pjesëmarrësit do të kishin mundësinë të njiheshin me përvojën profesionale dhe didaktike në këto vende.

¹ Data Gis Consulting, 2009

- ❖ Mësimdhënësit duhet vijuar kurse për aftësime në lidhje me metodat mësimore, që të përdoren pajisje me mjete konkretizimi moderne në klasa, laboratorë dhe objekte ku mbahet pjesa praktike. Për të pasur përmirësime duhet që rritja e kapacitetit të mësimdhënësve dhe mjeteve të punës në shkolla të jenë të bashkërenditura në mënyrë që të reformohet sistemi.

Metodat e realizimit të mësimit

Nga metodat e realizimit të mësimit mund të përdoren:

- ligjëratat klasike,
- ushtrime laboratorike dhe të terrenit
- metodat e mësimit bashkëveprues (interaktivë), individualisht apo në grup,
- diskutime në panel,
- debate formale,
- punëtori,
- hulumtimi i rasteve, dhe
- shkuarja e punimeve seminarike.

Një aksent i veçantë në mësimin aktiv i kushtohet:

- diskutimit,
- mësimit të përbashkët,
- krijimit të grupeve të mësimit,
- mësimi i bazuar në përvojën,
- metodat e stimulimit,
- vizita ne panairë te agrobiznesit,
- propozimeve hulumtuese dhe projekteve.

Pas çdo kapitulli të programit mësimorë, duhet vlerësuar të arriturat e nxënësve përmes testimit dhe kolokviumeve.

TË MËSUARIT PËR NDËRMARRËSI (MN)

Inkurajimi i shpirtit të ndërmarrësisë është thelbësor për krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e konkurrencës dhe zhvillimin ekonomik. Rëndësia e ndërmarrësisë, në ditët e sotme gjerësisht pranohet si një shkathtësi bazë, që mund të ofrohet nëpërmjet shkollimit profesional dhe mësimit gjatë gjithë jetës.

Edhe pse zhvillimi i ndërmarrësisë tek nxënësit është përcaktuar si njëri nga prioritetet e arsimit profesional, ndërmarrësia është fare pak e përfaqësuar në kurrikulat e shkollave bujqësore. Të gjitha aktivitetet eventuale që kanë të bëjnë me ndërmarrësinë në shkolla më tepër janë raste individuale se sa që ekziston ndonjë sistem i ndërtuar për të zhvilluar këto aftësi tek nxënësit. Përderisa në këtë lëmi kemi mungesë të theksuar të përfshirjes në kurrikulë, në anën tjetër kemi raste kur programet janë të mbingarkuara me lëndë dhe përmbajtje programore (brenda lëndëve), për të cilat nxënësit kanë shumë pak nevojë.

Zhvillimi i kësaj lëmie në shkolla kërkon ndërhyrje komplekse, duke filluar nga trajnimi i mësimeve të reja që ata të jenë në gjendje ti përcjellin këto njohuri tek nxënësit. Meqenëse kjo punë në masë të madhe është e lidhur me punën praktike të nxënësve, përmirësimi i mësimit praktik, është kusht për ta zhvilluar këtë lëmi.

Në fakt, nxënësit në të gjitha drejtimet e kanë një lëndë “Ekonomia dhe Ndërmarrësia”, edhe pse kjo lëndë nuk është e lidhur me pjesën praktike.

Shkathtësi relevante teknike dhe të biznesit nevojitet të afrohen te ata, që zgjedhin të vetëpunësohen dhe/ose të fillojnë biznesin e tyre, ose mendojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen. Sidoqoftë, ndërmarrësia nuk duhet të konsiderohet vetëm si mjet për krijimin e bizneseve të reja, por si një qëndrim i përgjithshëm, që mund të aplikohet mirë nga të gjithë në jetën e përditshme dhe në të gjitha aktivitetet e punës.

Ndërmarrësia tani me të madhe pranohet si një çështje e rëndësishme, që duhet të mësohet. Ajo që duket se ende mungon është një strukturë koherente, ashtu që aktivitetet dhe shembujt ekzistues të praktikës së mirë të mund të zënë vend në sistemin e arsimit dhe aftësimin.

Mësimi për ndërmarrësi pajisë nxënësit me aftësim të veçantë se si të fillohet dhe të udhëhiqet një biznes, përfshirë kapacitetin për të hartuar një plan real të biznesit dhe shkathtësitë të shoqëruara me metodat e identifikimit dhe vlerësimit të mundësive të biznesit ashtu që projektet mirë të hulumtuara mund të realizohen në praktikë dhe përfundimisht të arrijnë tregun. Mësimi për ndërmarrësi ka për qëllim:

- ngritja e vetëdijesimit të nxënësve për vetëpunësim si një opsion i karrierës (me njoftimin që ai/ajo mund të bëhet jo vetëm punëtor, por edhe ndërmarrës);
- promovimi i zhvillimit të kualiteteve personale, që janë relevante për ndërmarrësinë, siç janë kreativiteti, ndërmarrja e rrezikut dhe përgjegjësisë;
- ofrimi i shkathtësive teknike dhe shkathtësive të biznesit, të nevojshme për filluar dhe udhëhequr një biznes të ri;

Përveç të arriturave në kompetencat profesionale bujqësore, nxënësit duhet të tregojnë gjithashtu arritshmëri të caktuar në MN. Kjo do të shfaqet dhe matet përmes rezultateve mësimore të shprehura përmes njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, si në vijim:

Nxënësit njoftohen me botën ndërmarrëse reale të komunitetit lokal dhe me gjerë, dhe mund të:

- demonstrojnë njohuri themelore dhe të kuptuarit e natyrës së punës dhe mjedisit ekonomik e shoqëror
- demonstrojnë një vetëdijësim të parimeve themelore të tregut
- demonstrojnë një vetëdijësim për nevojat e tija / saja zhvilluese, interesat dhe aspiratat në karrierë

Nxënësit do të zhvillojnë shkathtësi ndërmarrësie, dhe do të jenë në gjendje të:

- gjenerojnë ide dhe të veprojnë sipas tyre
- zhvillojnë një plan veprimi
- komunikojnë ide në mënyrë efektive / shkathtësi të mira prezantuese dhe i arsyetojnë idetë e tyre te të tjerët
- luajnë rol efektiv në procesin e vendim marrjes, përmes ndikimit, negocimit dhe punës grupore efektive
- demonstrojnë qasje imagjinative dhe të informuara kundrejt zgjidhjes problemeve

Nxënësit do të zhvillojnë qëndrime ndërmarrësie, prandaj ata do të:

- kenë vetëbesim dhe dëshirë të marrin iniciativa
- mund të demonstrojnë shpirtin inovativ dhe kreativ
- mund të demonstrojnë aftësi të ndërmarrin risk të llogaritur/ të informuar
- jenë të vetëdijshëm të marrin përgjegjësi
- jenë në gjendje të dallojnë përparësitë dhe dobësitë e tyre personale

Rekomandime për hartimin e materialeve mësimore për ndërmarrësi

Kurrikuli për mësimin ndërmarrës nuk ka të bëjë vetëm me bizneset. Ai ka të bëjë me të mësuarit se si duhet të ballafaqohemi me botën reale, mbi menaxhimin e ndryshimeve, dhe me atë se si të nxënët ta përdorim në realitet.

Qasjet mbi të nxëniet dhe të mësuarit e ndërmarrësisë ndihmojnë nxënësit dhe të rinjtë të zhvillojnë aftësi dhe të arrijnë qëllimet e tyre në të gjithë lëmit e kurrikulit. Këto qasje karakterizohen me një angazhim permanent, të qëllimshëm dhe relevant (të rëndësishëm). Mësuesit i përdorin ato qasje që të forcojnë kulturën e qëndrimeve pozitive dhe të motivojnë nxënësit që të kenë besim dhe të jenë të suksesshëm. Përqendrimi bie në inkurajimin e nxënësve të marrin iniciativa lidhur me mësimet e tyre, zhvillimin e shkathtësive në punën me të tjerët, inkurajimin e nxënësve që të mësojnë nga sukseset dhe gabimet e tyre, të kuptojnë botën e punës dhe të pranojnë vlerat dhe mundësitë.

Kjo nuk është lëndë e re në kurrikul. Kjo është një qasje e mësimdhënies të cilësdo pjesë të kurrikulit dhe mund të shfrytëzohet në të gjithë lëmitë mësimore në shkollë.

Grupi hartues i kurrikulit për ndërmarrësi duhet ti ketë parasysh parimet si në vijim:

1. Hartuesit e kurrikulit duhet të njohin konceptet themelore të edukimit për ndërmarrës
2. Mësimdhënësit duhet të shikojnë përmbajtjet e kurrikulit dhe të shqyrtojnë mundësinë e mësimdhënies me një qasje ndërmarrësie.
3. Çdo nxënës, pavarësisht nga aftësia e tij, duhet të ketë mundësinë të merr pjesë aktive në aktivitetet ndërmarrëse në secilën lëndë ose lëmi së paku një here në gjysmëvjetor.
4. Mësimdhënësit duhet të marrin parasysh rezultatet mësimore dhe planin e aktiviteteve për ndërmarrësi, ashtu që të sigurojnë se të gjithë nxënësve u epet mundësia të përmbushin ato kërkesa.
5. Aspekti kryesor i mësimit ndërmarrës është gjithëpërfshirja aktive e nxënësve, e jo të mësuarit pasiv. Mësimdhënësit duhet të kenë parasysh mundësinë që nxënësi të përfshihet/inkuadrohet në mënyrë reale dhe praktike.
6. Mësimdhënësi duhet të merr parasysh metoda të ndryshme të vlerësimit, p.sh. lista kontrolli (vrotuese), vetëvlerësim i nxënësve, vlerësim i njëri tjetrit (i ndërsjellë).
7. Mësimdhënësve duhet tu epet mundësia të shkëmbejnë shembuj të praktikave të mira me mësimdhënës të lëndës së njëjtë por edhe me mësimdhënës të lëndëve tjera.
8. Shkolla duhet të ketë mundësi që së paku njëherë në gjysmëvjetor të shkëmbejë përvoja dhe praktika të mira me shkolla tjera të rajonit. Kjo mund të jetë në nivel lokal apo rajonal.
9. Nxënësit duhet të kenë mundësi të shkëmbejnë përvojat e tyre me të tjerët (nxënës të klasave/ shkollave tjera) dhe tu tregojnë atyre për mësimet e nxënë

- nga aktivitetet e të dy palëve. Me rëndësi është që të vlerësohet mësimi i tyre i nxënë.
10. Drejtorët e shkollave duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë aktivitetet ndërmarrëse të zhvilluara në shkollën e tyre, duke shfrytëzuar për këtë qëllim evidencën të ofruar nga mësimdhënësit (foto, raporte, portfolio nga puna e nxënësve, rezultate)
 11. Shkollat duhet të shpjegojnë prindërve filozofinë e mësimit ndërmarrës me qëllim që ata të jenë plotësisht të vetëdijshëm për përfitimet nga ky lloj i mësimit. Prindërit duhet të inkurajohen që të përkrahin këto aktivitete dhe të marrin pjesë kur është e përshtatshme.
 12. Shkollat duhet të shqyrtojnë mundësitë e punës me prindërit që janë në biznes në mënyrë që të sigurohet se nxënësit mund të shohin situata nga jeta reale. Marrëveshja mund të rregullohet qoftë në mënyrë zyrtare apo jozyrtare. Kjo gjë mund të ndihmojë në aktivitetet ndërmarrëse por edhe do tu ofronte nxënësve informata lidhur me mundësitë në karrierë. Këtu do të mund të përfshiheshin kompanitë lokale ose mund të ketë gjasa që ndonjë prind të jetë i punësuar.

Rekomandime për materialet mësimore

1. Mësimdhënësve duhet tu jepen udhëzues ku shpjegohet filozofia e edukimit ndërmarrës dhe sugjerime për mënyrat se si të përfshihet kjo në kurrikulin shkollor. Mësimdhënësit duhet të trajnohen për këtë qasje.
2. Duhet të hartohen materiale mësimore / të adaptohen për përdorim të nxënësve. Duhet të ketë një seri materialesh të cilat i përshtaten moshave të ndryshme të nxënësve. Këto materiale duhet fillimisht të testohen te një numër i caktuar i nxënësve para futjes në përdorim më të gjerë kombëtar.
3. Mësimi ndërmarrës ka mundësi të zbatohet edhe pa ndonjë prodhim të shtrenjtë të materialeve. Mësimdhënësit duhet të shkëmbejnë materialin mes veti. Mund të krijohet apo shfrytëzohet ndonjë platformë edukative, apo formë tjetër elektronike, ku mësimdhënësit mund të shkëmbejnë materialet të cilat ata vet i prodhojnë (në nivel kombëtar apo rajonal)

Trajnimi për mësimdhënësit:

1. Module themelore – “Kultura ndërmarrëse dhe ekonomia e aplikuar” – të gjithë mësimdhënësit – 2 ditë
2. Module aplikative – “Si të mësohet...” – 4 grupe: mësimdhënësit e shkencave shoqërore, shkencave natyrore, gjuhëve, etj.

3. Zhvillimi i moduleve për TM dhe Trajnim mësimdhënësish si parapërgatitje për hapat e mëtejshëm (mundësia e shfrytëzimit të Qendrës Regjonale/Akademisë)
4. Kandidatët më të mirë zgjedhën për vazhdim të aktiviteteve të TM

Burimet e nevojshme financiare

1. Mjetet mësimore
2. Modulet e trajnimit të trajnerëve dhe ato trajnuese janë të zhvilluara
3. Komunikimi Virtual për MN (EL) në zhvillim
 - materiale
 - praktikat më të mira
 - forume
 - politika të BE
 - tregime të suksesshme të NMV
 - partneriteti me sektorin privat/PPP
 - zhvillimi i karrierës në MN

Interesimi i nxënësve për regjistrimin në shkollat profesionale bujqësore

Sipas personelit arsimorë të intervistuar, shkollat më të popullarizuara janë gjimnazet ku regjistrohen nxënësit me notat më të mira nga shkolla fillore, ndërsa shkollat profesionale bujqësore mbesin si mundësi e dytë. Nga kjo e dhënë kuptohet se shkollat profesionale bujqësore që në fillim ballafaqohen me një strukturë të nxënësve me sukses më të dobët, prandaj nevojitet një angazhim më i madh dhe një qasje më profesionale e mësimdhënësve që nxënësit të fitojnë aftësitë dhe shkathhtësitë e nevojshme për jetë dhe tregun e punës.

Një ndikim të rëndësishëm për llojin e shkollës profesionale që e zgjedhin nxënësit e ka vendndodhja e shkollës, pasi shkollat më afër qendrës së qytetit janë më atraktive për nxënësit. Një rast të tillë e kemi hasur në shkollën në Gjilan, ku edhe pse Kuvendi Komunal ka ndarë një sipërfaqe jashtë qytetit për ngritjen e SHPB-së së bashku me hapësirën për përgatitjen praktike të nxënësve, kjo nuk pëlqehet nga drejtuesit dhe mësimdhënësit e shkollës pasi ekziston frika se interesimi i nxënësve për regjistrim do të zvogëlohet dukshëm.

Nxënësit nga fshatrat preferojnë shkollimin e mesëm të përgjithshëm, me shpresë se ky shkollim do t'i mundësojë atyre regjistrimin në fakultet, apo këtë e shohin si mundësi për t'u larguar nga hapësirat rurale.

Rekomandime për motivimin e nxënësve të regjistruar dhe aftësohen në SHPB-të

Motivimi është çelësi për rekrutimin e nxënësve me sukses të mirë dhe kyçjen e tyre në procesin mësimorë. Pasi nuk ekziston një formulë ideale për rekrutimin dhe kyçjen e

nxënësve më të mirë në shkollë, mësuesit dhe udhëheqësit e shkollës duhet provuar të ofrojnë aktivitete dhe mundësi të larmishme për joshje të nxënësve.

Është me rëndësi të determinohet interesimi i nxënësve për programet që ata i dëshirojnë. Nxënësit gjithnjë joshen nga programet e reja dhe aktuale, interesante dhe të kuptueshme për ta.

Mësimdhënësit e SHPB-ve duhet të jenë të adaptueshëm dhe kreativ në mënyrë që t'i ofrojnë nxënësve programe joshëse.

Përveç lëndëve tradicionale, mësimdhënësit duhet të joshin nxënësit me lëndë në hortikulturë, zhvillimin e peizazheve, turizmin rural, vizita nëpër ferma, pjesëmarrjen në panairë të agrobiznesit, etj.

Nxënësve mund t'u ofrohen kurse në menaxhimin e bujqësisë që përfshijnë aktivitete për të zhvilluar aftësitë për planifikim, organizim dhe zbatim të projekteve të ndryshme. Këto programe informojmë nxënësit dhe prindërit ë tyre që SHPB-të ofrojnë shumë përfitime praktike të nevojshme për punë dhe jetë.

SHPB-të nuk janë atraktive për rininë pasi janë të udhëhequr prej "ofertës" e jo prej "kërkesës" dhe nuk janë në përputhje me tregun aktual të punës. Një shembull pozitiv i drejtimit në bazë të kërkesës dhe në përputhje me tregun e punës e kemi hasur në shkollën bujqësore "Mosha Piade" në Tetovë, ku në drejtimin mësimorë Teknologji Ushqimore punësohen rreth 40-50% të nxënësve pas përfundimit të shkollimit.

SHPB-të duhet të angazhohen në promovimin e marrëdhënieve me publikun duke e përmirësuar imazhin e shkollës. Shkolla duhet ta bëjë të njohur profilin e saj me anë të fletëpalosjeve dhe të jetë prezent në mediet lokale. Aktivitete si panairi i produkteve të shkollës mund të rrisin aktraktivitetin e saj në vend dhe rajon.

Aftësimi praktik i nxënësve

Sistemi arsimor profesional bujqësorë po kalon nëpër vështirësi të ndryshme dhe assesi nuk po shfrytëzohen përvojat e avancuara perëndimore për përgatitjen e kuadrit profesional. Pjesa praktike e mësimit dhe bashkëpunimi i shkollave dhe bizneseve është në nivel shumë të ultë, andaj edhe niveli profesional dhe njohuritë praktike të nxënësve janë të mangëta.

Puna praktike duket të jetë lënë anash edhe pse është njëra ndër fushat kritike, sidomos për shkollimin profesional. Përveç mungesës së pajisjeve për punë praktike edhe te mësimdhënësit mungon aftësia dhe vullneti për punë praktike. Ekziston një nevojë urgjente për trajnimin e mësimdhënësve lidhur me mënyrën e zhvillimit të punës praktike me nxënësit.

Praktika profesionale në shkolla është ende në nivel shumë të ultë. Natyra e shkollave profesionale dallon nga ato të përgjithshmet/ gjimnazet, për arsye të specifikës tyre – praktikën profesionale. Ato nuk kanë një buxhet të ndryshëm nga gjimnazet, gjë që u pamundëson realizimin e specifikës së profilit të cilin e ofrojnë. Psh. Shkollat bujqësore nuk kanë të rregulluar punën e fermës së shkollës, pa të cilën nuk paramendohet praktika në bujqësi. Ato praktikisht duhet të funksionojnë si ndërmarrje dhe nëse nuk e kanë buxhetin e caktuar, ferma nuk mund të mbijetojë. Si shembull mund të merret ferma e Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, që përkundër një buxheti të mjaftueshëm dhe mbështetjes nga donatorët, e ka të vështirë të funksionojë si ndërmarrje e pavarur. Një përjashtim bën shkolla bujqësore në Lipjan, e cila siguron më shumë punë dhe mësim praktik, edhe pse shkolla mbështetet kryesisht nga donatorët.

Ka disa shembuj të mirë të realizimit të praktikës në ndërmarrje, por kjo bëhet me iniciativa/raporte private të shkollës me kompanitë, dhe jo në mënyrë institucionale për të gjitha shkollat.

Mungesa e materialeve themelore për mësim praktik po e dëmton shumë reformën e planprogrameve. Një shembull i kësaj është futja e ndryshimeve në planprograme pa trajnim adekuat të mësimdhënësve, pa materialet e nevojshme dhe pa objekte dhe pajisje mësimore adekuate. Ndryshimet duhet t'i përgjigjen nevojave qartë të definuar.

Shkollat nuk kanë objekte për zhvillim të praktikës apo pajisje për punë praktike dhe më pak se 20% e kohës mësimore kalohet në punë praktike, e që është më tepër një demonstrim sesa praktikë e vërtetë.

Pjesa praktike e mësimin të nxënësve nuk i plotëson as për së afërmi nevojat e biznesit vendor. Pasi biznesi vendor po ballafaqohet me vështirësi të shumta dhe pamundësi të konkurrimit në një treg të hapur, gradualisht po mbyllet edhe raportet tradicionalisht të mira në mes të komunitetit të biznesit në njërin anë dhe mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme në anën tjetër.

Komuniteti i biznesit kërkon të punësojë persona të kualifikuar dhe të ketë garanci rreth cilësisë së shërbimeve që mund të ofrojnë nxënësit pas kryerjes së shkollimit.

Rekomandime për ngritjen e aftësimin praktik të nxënësve

Është me rëndësi të identifikohen nevojat e biznesit dhe mundësitë e sistemit shkollor për përgatitjen e kuadrit profesional për sfidat me të cilat do të ballafaqohen kuadrot në praktikën për të cilën do të aftësohen. Në mungesë të një infrastrukture ligjore, pjesa praktike që duhet të mbahet nëpër organizata punuese shpesh bëhet në mënyrë të paorganizuar dhe mbështetet në vullnetin e ndërmarrësve dhe në aftësitë e mësimdhënësve që të organizojnë vizita nëpër ndërmarrje. Prandaj nevojitet që sa me

parë të përpilohet një kornizë ligjore për rregullimin e çështjes së mësimin praktik dhe të punësimit të praktikantëve.

Që biznesi të joshët për mbështetjen e pjesës praktike të mësimin të nxënësve, nevojiten masa stimuluese në formë të zvogëlimit të tatimit dhe taksave të ndryshme, promovimit të bizneseve që mbështesin shkollat, si dhe përvojat tjera pozitive për stimulimin e biznesit që duhet marrë nga vendet e rajonit dhe të BE-së. Kjo mund të arrihet me akte nënligjore, ku rregullohen marrëdhëniet ndërmjet shkollave profesionale dhe komunitetit të biznesit për të zgjidhur problemet e kuadrit, didaktike etj.

Duhet të institucionalizohet bashkëpunimit midis shkollave dhe biznesit vendor lokal për të shfrytëzuar me efektivitet infrastrukturën e këtyre aktorëve në funksion të përgatitjes profesionale të nxënësve. Bashkëpunimi me sektorin privat është shume i rëndësishëm në reformimin e arsimit dhe formimit profesional si dhe për të siguruar një shërbim që është i kërkuar nga tregu i punës.

Bashkëpunimi mes shkollës dhe komunitetit, punësimi dhe vazhdimi i arsimimit universitar

Bashkëpunimi me komunitetin


Me disa përjashtime, nuk ka gati fare marrëveshje ndërmjet shkollave profesionale dhe tregut vendor të punës apo komunitetit vendor ku shumica e nxënësve që e kanë kryer shkollën mbesin në shtëpi. Meqenëse nuk ekzistojnë forma të bashkëpunimit në mes shkollave përkatëse dhe biznese (fermat, bankat, njësit përpunuese, tregjet, etj), kontaktet në mes tyre janë fare të vështira. Kjo rrjedh si pasojë e mungesës së legjislacionit (komuniteti i biznesit do të kishte lehtësira nëse hyn në marrëdhënie kontraktuale me shkollat), mungesa e iniciativat nga shkollat dhe zhvillimit të ulet të biznesit vendor.

Punësimi

Edhe pse bujqësia është ndër degët më të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë, të dhënat nga zyrat rajonale të punësimit tregojnë, siç është paraqitur në Graf. 1, se numri i të punësuarve është shumë i vogël në krahasim me nxënësit e diplomuar. Është marrë shembulli i SHPB në Ferizaj, por përafërsisht numri i të punësuarve është i njëjtë edhe në shkollat tjera profesionale në Kosovë.

Çelësi për zhvillimin afatgjatë të ekonomisë rurale dhe krijimin e vendeve të punës varet shumë nga ngritja e prodhimit të bujqësore dhe shumëllojshmëria e ekonomisë rurale përmes përkrahjes fermave të vogla dhe ndërmarrjeve, NMV-s. Kjo kërkon trajnime për shkathtësi të avancuara teknike dhe menaxhuese.

Ndonëse ekziston potenciali për zhvillim të zonave rurale, për arsye të mungesës së shkathtësive dhe burimeve arsimore për ta përkrahur këtë zhvillim, nuk shfrytëzohet fare ky potencial.



Numri i vogël i të punësuarve rrjedh si pasojë e mungesës së kapaciteteve absorbuese të tregut të punës dhe nivelit të ulët të aftësisë të nxënësve pas përfundimit të shkollimit.


Grafiku 1: Shkalla e të punësuarve të diplomuar nga SHMP "Zenel Hajdini" në Ferizaj

Rezultatet nga grafiku 1, janë shumë dekurajuese nisur nga fakti se në përgjithësi shkollat profesionale si qellim parësor e kanë përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. Nga të gjitha vitet e hulumtuara shkalla e punësimit është me e vogël se 10%, me një trend të vogël pozitiv në vitet e fundit².

Regjistrimi i nxënësve në Universitet

Suksesi i nxënësve të SHPB-ve këtë vit ka qenë shumë i dobët me një mesatare të kalueshmërisë në testin e maturës prej rreth 4%. Përveç ngritjeve të parametrave më lartë të përmendur, duhet të qartësohet mënyra e organizimit të provimit për shkollat profesionale dhe materialet ekzistuese dhe metodologjia e shkollimit duhet përshtatur testit të maturës.

² Te dhenat për vitin 2009 ka gjase të jenë me të larta deri në fund të vitit.



Regjistrimi në universitet i nxënësve të diplomuar në shkollat e mesme profesionale është shumë i vogël (Grafiku 2). Megjithëse nga viti 2005 e deri në vitin 2009 kemi një rritje të shkallës së regjistrimit në universitet të nxënësve, prapëse prapë kjo është në nivel jo të kënaqshëm.

Grafiku 2: Regjistrimi i nxënësve të diplomuar në universitet

Përhapja gjeografike e shkollave profesionale bujqësore

Shkollat profesionale duhet të jenë rajonale, të ngrihen sipas nevojave, traditës dhe mundësive për bazë didaktike efikase. Shkollat profesionale bujqësore janë të vendosura në pjesën lindore të Kosovës në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Lipjan. Numri i nxënësve që vijon mësimin në këto shkolla është rreth 1500, prej të cilëve 40% janë femra. Megjithatë, në pjesën perëndimore, në rrafshin e Dukagjinit, ku kushtet për zhvillimin e bujqësisë janë më të volitshme, vetëm një numër i vogël nxënësish ndjekin mësimet në lëmin e bujqësisë. Ekziston SHPB në Pejë, por interesimi i nxënësve për regjistrim në këtë shkollë është i vogël. Prandaj sugjerojmë të shikohet mundësia e themelimit të SHPB-ve në rrafshin e Dukagjinit në mënyrë që të zhvillohet potenciali bujqësor i kësaj zone.

Emërtimi më atraktiv i drejtimeve studimore për joshjen e nxënësve për shkollim dhe aftësim profesional

Preferencat e të rinjve për regjistrim në shkollat e mesme profesionale varen shumë nga emërtimet e drejtimeve si dhe nga perceptimi për mundësinë e punësimit pas përfundimit të shkollimit. Drejtimi i hortikulturës është pëlqyer më së shumti nga të rinjtë me rreth 53-55%, drejtimi i teknologjisë ushqimore dhe mbrojtjes së bimëve me rreth 48%, dhe i fermerit me 42-45%. Drejtimet tjera si: Blegtori, Lavërtari – Perimtari,

Përpunimit të drurit, Veterinarisë dhe ai i Pylltarisë nuk janë interesante për nxënësit pasi regjistrohen një numër më i vogël nxënësish.³

Nga kjo e dhënë duhet të merret në konsiderim riemërtimi i drejtimeve që ato të janë më atraktive për nxënësit dhe prindërit.

Nga përvojat e vendeve të rajonit, hapja e drejtimit të Agrobiznesit ka çuar në një rritje të dukshme të numrit të nxënësve në shkollat bujqësore.

Rekomandimet për ndryshimin e emërimit të drejtimeve studimore

Që të jenë më atraktive për nxënësit, rekomandojmë që drejtimit ekzistues të riemërohen si vijon:

Drejtimi Lavërtari - Perimtari të emërohet Teknologjia e Prodhimit Bimor

Drejtimi Blegtori – të emërohet Teknologjia e Prodhimit Shtazor (Animal)

Drejtimi Fermer – të emërohet Agrobiznesi

Propozimi për drejtime të reja më atraktive

Menaxhimi i Agrobiznesit

Drejtimi i agrobiznesit i përgatitë nxënësit të zhvillojnë aftësi të menaxhimit të ndërmarrjeve të sektorit të bujqësisë, agroturizmit dhe industrisë ushqimore.

Menaxhimi i marketingut në industrinë ushqimore

Ky specializim dizajnohet për nxënësit që dëshirojnë të vazhdojnë karrierën në shumë fusha të lidhura me industrinë ushqimore, duke filluar nga sigurimi i lëndës së parë e deri të përpunimi, shpërndarja, shitja, marketingu dhe perspektiva e konsumatorëve

Kopshtaria urbane

Nxënësit që e përfundojnë këtë drejtim mësojnë të aplikojnë principet bazike të teknologjisë kopshtare dhe rregullimit të kopshteve urbane. Nxënësit aftësohen në planifikimin dhe dizajnimin e peizazheve, zgjedhjen dhe përmirësimin e dheut për mbjellje të bimëve, zgjedhjen e bimëve të përshtatshme, menaxhimin e ujitjes dhe plehërimit të bimëve, dhe praktikave tjera për mirëmbajtjen e kopshteve.

³ Data Gis Consulting, 2009

Bujqësia Precize

Drejtimi do të ofrojë një qasje inovative për përmirësimin e procesit të prodhimit në fermë duke menaxhuar me precizitet çdo veprim të rëndësishëm në prodhimtarinë bujqësore me qëllim të arritjes së prodhimtarisë maksimale, në të njëjtën kohë duke promovuar mbrojtjen e ambientit. Nxënësit do të aftësohen për përdorimin e teknologjive të avancuara për menaxhimin specifik të tokës dhe bimës siç janë: Sistemi i Pozicionimit Gjeografik (GPS), Sistemin Informativ Gjeografik (GIS), teknikat e përgatitjes së hartave të bimëve dhe tokës, Menaxhimi dhe Ruajtja e Mjedisit, etj.

Rekomandime për shkollat profesionale bujqësore

Gjate vizitave dhe bisedave të realizuara me personat përgjegjës për këto çështje (kryesisht anëtarët e grupit referent) janë identifikuar disa probleme dhe sfida në shkollat e përfshira në projekt.

- ✚ Nevojë për organizim dhe përfshirje shumë më të mirë të nxënësve në punë praktike (ngritja e kapaciteteve praktike neper shkolla, forma kontratash mes shkollave dhe Industrive përkatëse për kryerjen e Internship-it / punës praktike te nxënësve). Detaji i planit të praktikës për nxënës (përcjellja dhe monitorimi i nxënësve nga arsimtaret, krijimi i raporteve te rëndësishme për të dy palët fermer/industri-nxënës, etj).
- ✚ Fuqizimi i masave të marrëdhënive me publikun dhe rritjen e shkallës së njohjes së shkollës në rajon, përmes daljes në media lokale, fletëpalosjeve, etj.
- ✚ Mungese e pjesëmarrjes ne aktivitete si panairi i produkteve të përfituara në shkollë, do e bëjnë të mundur prezantimin e shkollës dhe aktiviteteve të saj në rajon.
- ✚ Nevojë imediate për organizimin e trajnimeve teknike për arsimtar (deri me tani këto mungojnë fare, ka pasur vetëm disa trajnime pedagogjike).
- ✚ Rishikim i emrit të drejtimeve aty ku ka nevojë për të nxitur atraksionin e të rinjve (p.sh. Blegtori, Lavërtari, Fermer, etj).
- ✚ Themelimi i drejtimeve te reja te cilat do jene plotësim i atyre ekzistuese, specifike për industritë përkatëse dhe ne trend aktual për zhvillimet e reja te tregut. Këto drejtime potenciale kërkojnë aprovim nga MASHT dhe duhet të arsyetohet mirë ne te gjitha aspektet.
- ✚ Organizim më i fuqishëm i kampanjës nëpër shkolla fillore për te nxitur imazhin/interesin e të rinjve me sukses më të mirë për të ndjekur shkollën Bujqësore (afërsisht 70% e nxënësve vijnë nga shkolla me sukses te mjaftueshëm, ne raport me >10 % janë te shkëlqyeshëm).

- ✚ Mungesa e vlerësimit të tregut potencial të punës për shkollat profesionale ka efekt negative edhe në orientimin e këtyre shkollave në të ardhmen.
- ✚ Bashkëpunim shumë i ulët në mes shkollave simotra në vend (vetëm me shkollën e Lipjanit të gjitha shkollat kanë bashkëpunim).
- ✚ Programet e të katër profileve kanë mangësi të cilat lehtë duhet të përmirësohen.
- ✚ Përpilimi i teksteve mësimore adekuate dhe zbatimi i tyre do të përmirësojë dukshëm cilësinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies në SHPB-të.
- ✚ Mundësia e dhënies së bursave për nxënësit si masë joshëse.
- ✚ Duhet të konsiderohet ri-emërimi i disa profileve ekzistuese me qëllim të rritjes së atraktivitetit të të rinjve (p.sh. Blegtori, Lavërtari, etj).
- ✚ Ofrimi i mundësisë për regjistrimin të nxënësve të shkëlqyeshëm pa ndonjë konkurs/ provim pranues në njërin nga drejtimit bujqësorë në Fakultet.
- ✚ Trajnimi teknik/profesional i arsimtarëve është nevojë imediate për të freskuar metodat e punës, zbatimin e praktikave të reja, etj.
- ✚ Hulimtimi i mundësive dhe kapaciteteve për zhvillimin e bujqësisë dhe punësimit në regjion/komunë (prodhimi primar, përpunim, etj).
- ✚ Themelimi i bazës së shënimeve për shkallën e të punësuarve pas nivelit të parë, dytë dhe tretë (deri me tani pothuaj se të gjithë vazhdojnë deri në klasën e 13).
- ✚ Absorbimi i programeve mësimore nga nxënësit mbetet problem i madh, përmirësimi i metodave të mësimdhënies, aplikimi i drejtë i praktikës profesionale, përdorimi i materialeve mësimore adekuate për shkollat profesionale bujqësore, tej, do kishte efekt pozitiv në mesimnxënie nga ana e nxënësve nga këto shkolla.
- ✚ Kapacitetet industriale dhe fermat bujqësore janë tejet të vogla dhe me vështirësi lejojnë profilizimin e thellë të drejtimit/profileve bujqësore.
- ✚ Tregu i punës/industria nuk do të absorbojë kuadrin e kualifikuar, por që posedojnë shkallën e ulët të praktikës profesionale.

Konkluzion i përgjithshëm:

Shkollave profesionale bujqësore duhet që në spektrin e tyre profesional të kenë parasysh përgatitjen e njerëzve të rinj dhe të rriturve të kualifikuar për tregun e punës, të zhvillojnë dhe zbatojnë metodat e reja edukative- arsimore në përputhje me standardet e rajonit dhe të Evropës, të zhvillojnë planprograme të reja brenda kornizës së autonomisë së shkollës dhe standardeve të BE-së, mbështesin zhvillimin e tregut të punës bazuar në kriteret e ekonomisë së tregut, ndihmojnë shoqërinë kosovare në zhvillimin e një sistemi arsimor dhe një sistemi të punësimit të orientuar drejt Evropës.

Objektivat e shkollave profesionale duhet të janë që:

- të përgatisin njerëzit e rinj të kualifikuar dhe të rriturit për tregun e punës,
- të zhvillojnë dhe zbatojnë metodat e reja edukative- arsimore në përputhje me standardet e rajonit dhe të Evropës,
- të zhvillojnë planprograme të reja brenda kornizës së autonomisë së shkollës dhe standardeve të BE-së,
- të mbështesin zhvillimin e tregut të punës bazuar në kriteret e ekonomisë së tregut,
- të ndihmojnë shoqërinë kosovare në zhvillimin e një sistemi arsimor dhe një sistemi të punësimit të orientuar drejt Evropës.

BIBLIOGRAFIA

FAO/UNESCO (2002), Arsimi dhe edukimi për zhvillim rural. Në drejtim të politikave të reja.

KEC (2001) ,Arsimi në Kosovë 2000/01. KEC Prishtinë

MASHT (2003a) , Strategjia e arsimit të Kosovës, Prishtinë

MASHT (2003b) , Strategjia për zhvillim të arsimit profesional të Kosovës.

IPVQ(2002), Ligji (nr. 2002/2) mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës

ESK (2001) , Statistika mbi arsimin në Kosovë.

UNICEF (2003), Analiza e situatës së arsimit në Kosovë.

FAO 2004, Strategjia e arsimit për popullsinë rurale në Kosovë (2004 – 2009)

Data GIS Consulting 2009, Hulumtimi mbi interesat, opinionet dhe qëndrimet e të rinjve në zhvillimin e karrierës së tyre profesionale në bujqësi. Studim për MASH/Danida

SHTOJCA

PYETËSOR PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE NË SHKOLLAT PROFESIONALE BUJQËSORE NË KOSOVË

- Cilat drejtime/profile nga fusha e bujqësisë ekzistojnë në shkollën Tuaj ?
- Si është interesimi për t'u regjistruar në këto shkolla ?

Ulët Mesatar Lartë

- Cili është raporti gjinor në mes nxënësve ?

Femra _____ % Meshkuj _____ %

- Cili është sukcesi i nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale bujqësore ?

Mjaftueshëm _____% Mirë _____% Shumë mirë _____% Shkelq _____%

- Për cilat drejtime të shkollës Bujqësore ka interesim më të madh ?

- a) Blegtori
- b) Lavërtari-Perimtari
- c) Pemëtari-Vreshtari
- d) Teknologji Ushqimore
- e) Hortikulture
- f) Agro-ekonomi
- g) Te tjera specifiko _____

- Përse mendoni se në këto interesim më të madh ?

- a) Plan programe më atraktive
- b) Mundësi punësimi më të lehtë
- c) Ofron përparësi/lehtësi për studime në Fakultetin e Bujqësisë
- d) Emërimi i drejtimit është me atraktive
- e) Lidhje më të mira me industrinë përkatëse
- f) Të tjera, specifiko _____

- A ka drejtime në shkollën Bujqësore të cilat janë mbyllur për shkak të mosinteresimit të nxënësve për t'u regjistruar, nëse Po përse mendoni se ka ndodh kjo ?
-
-

- Si është i organizuar mësimi praktik ?

Në shkollë _____% Jashtë shkolle _____%

- Bazuar ne programet mësimore për drejtimet përkatëse mësimi praktik realizohet në shkollën?

100% < 50% > 50% 0%

- A organizon shkolla vizita/ekskursione profesionale në fermat e ndryshme, panaire etj ?

Po Jo

- A janë të mbuluara të gjitha lëndët me tekste/dispensa mësimore ?

Plotësisht Pjesërisht Fare nuk ka

- A jeni në dijeni se sa këto programe mësimore janë në përputhje me vendet tjera (në rajon dhe në Evropë) ?

- a) Janë plotësisht kompatible me ato në rajon
- b) Janë pjesërisht kompatible me ato në rajon
- c) Nuk janë fare kompatible me ato në rajon

- Si është mundësia e punësimit të nxënësve që përfundojnë shkollën Bujqësore ?

Të mëdha Mesatarisht Të dobëta Nuk ka mundësi fare

- Në cilat Fakultete regjistrohen kryesisht (ata që vendosin ta vazhdojnë shkollimin)?
 - a) Fakultetin e Bujqësisë;
 - b) Fakultete tjera në Universitetin e Prishtinës ;
 - c) Fakultete Private;
 - d) Të tjera specifiko _____

- A ekziston lidhje/bashkëpunim në mes shkollës profesionale bujqësore dhe bizneseve (fermave, industrive përpunuese, etj) për lëmit përkatëse ?, nëse Po, si është e zhvilluar kjo ? .
 - a) kontratë e rregullt mes shkollës dhe biznesit
 - b) pa kontratë të rregullt
 - c) të tjera forma specifiko _____

- Çfarë mendoni Ju se duhet te ndryshohet ne mënyrë qe te përmirësohet cilësia e mësimnxënies nga nxënësit dhe mësimeve ?
 - a) Sigurim te teksteve/dispensave mësimore
 - b) Sigurim te trajnimeve (rifreskim) teknike për arsimtare
 - c) Sigurim me te larte te shkollimit praktik (laboratorë, ferma, etj)
 - d) Te tjera specifiko _____